



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE**

Nr. 1009 Prot.

Tiranë, më datë 09.11.2020

**VENDIM**

**Nr. 371, datë 06.11.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.11.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Godinë me funksion banim dhe shërbime, 3 kate +1 kat nën tokë, faza 01, pranë rrugës” Ismail Qemali”, Korçë, aplikues Ina Disha, pronar Donika Stasa, zhvillues “Bregu” sh.p.k., në zonë me potencial arkeologjik, dhe raport i monitorimit arkeologjik të realizuar nga personi i licencuar në arkeologji z. Ols Lafe, rishikim i vendimit Nr. 298, datë 21.08.2020;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Godinë me funksion banim dhe shërbime, 3 kate +1 kat nën tokë, faza 01 dhe faza 02, pranë rrugës” Ismail Qemali”, Korçë” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**

**Arta DOLLANI**